



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 16 REGJISTRI TË PARAQITUR NË KQZ
NGA PARTIA EDMOND PIROLI KANDIDAT I PROPOZIAR NGA PARTIA BINDJA
DEMOKRATIKE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 09.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

KËRKUES: Edmond Piroli, kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike.

OBJEKT: Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të 76 Qendrat e Votimit në KZAZ-15 për Bashkinë Kurbin, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 1, neni 124, pika 1, neni 135, neni 143, pika 1, gërma a, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e palëve,

VËREN

Z. Edmond Piroli, kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr.16, datë 05.07.2019, me objekt "Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të 76 Qendrat e Votimit në KZAZ-15 për Bashkinë Kurbin, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve". për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën e datës 29.05.2019, ora 10:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr.16 regj., sipas objektit të sipërcituar.



Nr. 1041 i Vendimit Data 09.07.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 16, datë 05.07.2019, të paraqitur nga z. Edmond Piroli, kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike

Në mbledhjen e datës 09.07.2019, KQZ përpara nisjes së hetimit administrativ në mbështetje të nenit 135, pika 3 verifikoi legjitimitetin e palëve dhe konstatoi se për ankimin nr. 16 subjekti ankues i vetëm, është z. Edmond Piroli, kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike.

Neni 124, pika 1 e Kodit Zgjedhor, të drejtën e ankimit e ka cdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që çënojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

Referuar dispozitës së sipërcituar ankuesi z. Edmond Piroli, kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike nuk gëzon të drejtën për të ankimuar Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të 76 Qendrat e Votimit në KZAZ-15 për Bashkinë Kurbin, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve. Në këtë rast është subjekti zgjedhor Bindja Demokratike që ka të drejtën të bëjë ankim administrativ.

KQZ, vlerëson se z. Edmond Piroli nuk legjitimohet për të bërë ankim pranë Komisioni Qendror të Zgjedhjeve për të kërkuar Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të 76 Qendrat e Votimit në KZAZ-15 për Bashkinë Kurbin.

Për sa më sipër, kërkesa ankimore e z. Edmond Piroli duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 21, pika 1, 124, 135 pika 3, 143, pika 1, germa "a" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pushimin e kërkesës ankimore nr.16, datë 09.07.2019 të z. Edmond Piroli, kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 1041 i Vendimit Data 09.07.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 16, datë 05.07.2019, të paraqitur nga z. Edmond Piroli, kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike